



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 88, datë 30.03.2023



PËR

MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN NR. 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 118, DATË 27.10.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 5, RRUGA “DAVID SELENICA”, PALLATI NR. 18, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 118, datë 27.10.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr. 5, rruga “David Selenica”, pallati nr. 18, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5” i

ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e një shtese në Aneksin nr. 1, në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 118, datë 27.10.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr. 5, rruga “David Selenica”, pallati nr. 18, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.
2. Miratimin e përfshirjes në Aneksin nr.1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak, nr.118, datë 27.10.2022 si përfituese znj. Odeta Sofka në masën e strukturës së njësisë së banimit 1+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 03.04.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 232 / prot.
12

Durrës, më 06.04 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.88 datë 30.03.2023 “Për miratimin e një shtese në aneksin nr. 1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 118, datë 27.10.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative nr. 5, rruga “David Selenica”, pallati nr. 18, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019..

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

